



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 11. 05. 2010, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

Mungoi: Ibrahim Selmanaj.

Pjesëmarrës tjerë: Saniye Berisha – OSBE, Xhemajl Ahmeti – OHCHR, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit dhe Lindita Azizi – RTK.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi Ismet Beqiri.

***Kryetari** konstatoi se në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.*

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 20 dhe 27. 4. 2010,
3. Nxjerrja e përfundimeve lidhur me kërkesat e pensionistëve, të dala nga dëgjimi publik,
4. Pikat që dalin nga Plani i veprimit për Komisionin (afatet),
5. Shqyrtimi i petitionit të SPPTK-së,
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2 . Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 20 dhe 27. 4. 2010

Komisioni i miratoi pa vërejtje procesverbalet e 20 dhe 27. 4. 2010.

3. Nxjerrja e përfundimeve lidhur me kërkesat e pensionistëve, të dala nga dëgjimi Publik

Ismet Beqiri - kryetar - I njoftoi të pranishmit se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në dëgjimin publik, të mbajtur më 20. 04. 2010, në të cilin ishin të pranishëm anëtarët e Komisionit, e shqyrtoi peticionin e Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve dhe të Invalidëve të Punës së Kosovës dhe kërkoj nga anëtarët ta jepnin kontributin në formulimin rekomandimeve në mënyrë që t'i procedohen Kuvendit të Kosovës. Lidhur me këtë pikë hapi debat.

Drita Maliqi - Theksoi se në dëgjimin publik kam propozuar, por po e përsëris të shikohet mundësia që Komisioni ta themelojë një nënkomision, i cili do të merret me rekomandimet e miratuara të Kuvendit të Kosovës në vitin 2005, por që nuk janë zbatuar.

Hajredin Hyseni - U pajtua me propozimin e kryetarit që kjo çështje të debatohet në Kuvend, por nuk u pajtua me propozimin për themelimin e një nënkomisioni. Sipas tij po të themelohej nënkomisioni, rekomandimi për debat në Kuvend nuk do të duhej të dërgohej. U pajtua të kërkohej nga Kuvend lejimi i debatit.

Ibrahim Makolli - Cili do të ishte rezultati këtij debati? Tha se Fondi Fensional nuk ekziston më. Përpjekjet për negociata me Serbinë, që ka deklaruar se Fondi është harxhuar dhe në të nuk është deponuar më që nga viti 1990. Nëse në Kuvend kërkohej debat lidhur me këtë çështje, cili do të ishte rezultati? Po ashtu pyeti: A mund ta krijojë Kosova një fond pensional, prej të cilit do t'u jepeshin pensione atyre që kanë kontribuar në të kaluarën? Ishte i mendimit se për këtë çështje Komisioni do duhej të kërkonte nga Qeveria njoftim pse nuk janë zbatuar rekomandimet për pensionet? Një nga propozimet e Komisionit do të ishte se për shkak të mungesës së mjeteve, 5 % e mjeteve nga Fondi i Privatizimit të barten në Fondin Pensional, që të jepeshin pensionet për këtë kategori Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit të Kosovës t'ia paraqesë këtë

REKOMANDIM

- I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës që në njërën nga mbledhjet e ardhshme të debatojë edhe për gjendjen e rëndë të pensionistëve të Kosovës.
- Komisioni i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që pas shqyrtimit të kësaj çështjeje t'i miratojë propozimet e Komisioni dhe t'ia dërgojë Qeverisë.

P R O P O Z I M E

1. Me procedurë urgjente të përgatitet Projektligji gjithëpërfshirës për sigurimin pensional dhe invalidor. Ky Ligj duhet t'i përfshijë: sistemin e aplikuar të Trustit të Pensioneve të Kosovës dhe Skemën e pensioneve, të menaxhuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.
2. Të marrë masa konkrete për reformimin e Skemës së pensioneve, të menaxhuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, në mënyrë që nga kjo të përfitojnë personat që kanë kontribuar në Fondin e Pensioneve të Kosovës.
Në të njëjtën kohë, përfituesit e tjerë të tanishëm, të mos mbeten pa beneficione, por të barten në Skemën e ndihmës sociale të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale.
3. Qeveria e Kosovës, për çështjen e Fondit të grabitur të pensioneve, duhet të negociojë me Qeverinë e Serbisë dhe kjo të përfshihet në agjendë.
4. Ta shqyrtojë mundësinë e rritjes së pensioneve për personat që kanë kontribuar në fondin e pensioneve të mëparshme.

4. Pikat që dalin nga Plani i veprimit për Komisionin (afatet)

Kryetari - Theksoi se Kuvendi e ka ngarkuar Komisionin për shqyrtimin e Planit të veprimit dhe kërkon të respektohen afatet. Duket se në maj do t'i kemi për shqyrtim dy pika: 30 dhe 31. Në pikën 30 kërkohet nga Komisioni, që në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës, të organizojnë dëgjim publik për krijimin e njësisë komunale, për të drejtat e njeriut dhe t'i përgatitin rekomandimet për seancë plenare. Lidhur me këtë çështje diskutuan deputetët: Ibrahim Makolli, Drita Maliqi, Hajredin Hyseni, të cilët kontribuan të gjenden mënyra për organizimin e mbledhjeve të përbashkëta të Komisionit me ministritë dhe me institucionet e tjera.

Drita Maliqi – Sërish e pyeti Komisionin: Nuk e di se në bazë të të cilit ligj janë themeluar zyrat për të drejtat e njeriut? E kemi Ligjin për barazi gjinore. Sipas tij duhet të funksionojnë zyrat për barazi gjinore, të cilat janë kthyer në zyra për të drejtat e njeriut. Ishte e mendimit se në këtë fushë është shkelur Ligji për barazi gjinore. Po ashtu kërkoi nga Komisioni t'i rekomandohet Qeverisë ta procedojë Projektligjin, të cilin e kemi kërkuar disa herë, por nuk na e kanë sjellë.

Komisioni lidhur me pikat e Planit të veprimit e nxori këtë

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni vendosi që në maj dhe në qershor të organizohen takime me Asociacionin e komunave dhe me Ministrin e Pushtetit Lokal,
- II. Komisioni do të kërkojë njoftim nga Avokati i Popullit për vonesës e procedimit të Raportit të Avokatit të Popullit,

- III. Komisioni do të mbajë takim të përbashkët me Komisionin qeveritar për Persona të Pagjetur.
- IV. Komisioni u pajtua që nga Zyra e Kryeministrit të kërkohet me shkrim pse nuk është proceduar Projektligji për personat e pagjetur.

Komisioni i shqyrtoi edhe pikat e tjera të Planit të veprimit. U zotua se në afat optimal do t'i shqyrtojë dhe për to do ta njoftojë Komisionin Parlamentar për Integritet.

5. Shqyrtimi i petitionit të SPPTK-së

Nerxhivane Dauti - Sindikata e Pavarur e Postës dhe e Telekomit të Kosovës kërkon të ndërpritet procesi i privatizimit. I parashtron kërkesë Qeverisë së Kosovës që në strategjinë legislative për vitin 2010 të parashihet Projektligji për privatizimin e PTK-së dhe anëtarët e kësaj Sindikate të marrin pjesë në hartimin tij. Njëherësh kërkon që para privatizimit të PTK-së të nënshkruhet kontrata kolektive nga SPPTK-ja dhe nga përfaqësuesi i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesit e SPPTK-së të marrin pjesë si anëtarë të barabartë të Komisionit në fazën e negociimit të marrëveshjes dhe të nënshkrimit të kontratës së privatizimit.

Komisioni konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj i rekomandon Sindikatës së Pavarur të Postës dhe të Telekomit të Kosovës, t'i drejtohet Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Drita Maliqi – U shpreh kundër procesit të privatizimi të PTK-së dhe të Aeroportit.

6. Të ndryshme

Komisioni e shqyrtoi Peticionin e qytetarëve të Kaçaniku të Vjetër dhe të Stagovës lidhur me pasojat që u shkaktohen nga ujërat e zeza që derdhen në lumin Nerodime.

Nerxhivane Dauti - Ne cilësinë e raportueses i njoftoi me përmbajtjen e petitionit. Nënshkruesit e petitionit theksojnë se gjatë muajve të verës, duke filluar nga qershori e deri në shtator, kur të reshurat atmosferike mungojnë, lumi Nerodime sjell ujëra të zeza. Nga era e keqe nuk mund të jetohet në afërsi prej 2 km. Gjithashtu theksohet se këto janë të dëmshme për shëndetin e qytetarëve dhe shprehin frikë se mund të paraqitet ndonjë epidemi.

Me këtë petition i kemi njoftuar institucionet shtetërore të nivelit lokal dhe të atij qendror që të marrin masa paraprake për parandalimin dhe për sanimin e gjendjes.

Komisioni u rekomandon nënshkruesve të petitionit t'i drejtohen Ministrisë së Ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor që ta zgjidhë këtë çështje në përputhje me Ligjin për ujërat.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri